

VENDIM
Nr. 247, datë 9.5.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 400, DATË 1.6.2016, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PJESEMMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK TË BASHKIMIT
EVROPIAN, ME MISION TRAJNUES, NË REPUBLIKËN E MALIT, NË AFRIKË”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 103/2012, “Për ratifikimin e marrë-veshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për krijimin e kuadrit për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionet e menaxhimit të krizave të Bashkimit Evropian”, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 400, datë 1.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “b”, të pikës 1, data “...30 qershor 2018...” ndryshon dhe bëhet “...31 dhjetor 2019...”;

b) Në pikën 3, data “...30 qershor 2018...” ndryshon dhe bëhet “...31 dhjetor 2019...”.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama